

Valdeta Zenuni-Idrizi, PhD¹

UDC:
37.035:316.723-021.463

MULTIKULTURALIZMI NË ARSIM

МУЛТИКУЛТУРАЛИЗМОТ ВО ОБРАЗОВАНИЕТО

MULTIKULTURALISM IN THE EDUCATION

Abstract

In general, multikulturalism is defined by a heterogeneous society where present in the same space are many different cultures, whose fundamental characteristic is the distinctiveness. The multiculturalism in his basic opinion means accepting and promotion of different cultures, with main purpose to achieve equal interest and values in different spheres. The social organization of the human community, throughout the history of its civilization is characterized by the existence, coexistence and interaction of cultures, ethnicities and different religions. Multiculturalism is oriented toward the protection of the particular, the roots of tradition and history of each group without exception. Therefore, addressing the problem of muticulturalism requires a very serious and comprehensive. Our aim is to examine the elements that contribute to the presentation of multiculturalism in the education sphere, because multiculturalism in education is the basis for mutual understanding and for building contemporary society. This paper will briefly analyze ethnic relations in education and the politics that leads to their improvement in order to build a cohesive society. At the end we are concluding, that only on this way without religious, ethnics or another divisions of the world, the world can function homogeneous and uniformly.

¹ Universiteti i Tetovës, Fakulteti Filozofik, Programi studimor: Pedagogji, Tetovë, Republika e Maqedonisë, valdeta.zenuni@unite.edu.mk

Keywords: multiculturalism, education, teaching, interethnic relations, coexistence.

HYRJE

Punimi në lidhje me Multikulturalizmin dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim, paraqet një analizë të situatës aktuale në sistemin arsimor në lidhje me promovimin e respektit, tolerances dhe komunikimit të mirëfilltë ndërmjet nxënësve, arsimtarëve dhe prindërve të etnikumeve të ndryshme, dhe për të promovuar multikulturalizëm dhe përmirësim të marrëdhënieve ndëretnike në shkollat tona.

Qasja dhe marrja me këtë çështje duhet të jetë e bazuar në kuptimin se arsimi multikulturor është i orientuar në drejtim të përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe është karakteristikë kryesore e arsimit kualitativ, dhe si i tillë kontribuon për krijimin e kapaciteteve më të mira njerëzore dhe për ndërtimin e shoqërisë kohezive. Pra, multikulturalizmi në arsim paraqet bazë për mirëkuptim reciprok dhe bashkëjetesë në një vend të përbërë nga etnitete dhe gërshetime të kulturave e religjioneve të ndryshme, në një pluralizëm kulturor në hapësirë të caktuar, në një mozaik të shoqërisë në të cilën jetojnë pranë njëri tjetrit etnikume të ndryshme me gjuhë dhe kultura të ndryshme. Prandaj, qëllimi i multikulturës nuk është që kulturat të shkrihen njëra në tjetrën, por që të bashkëpunojnë, komunikojnë dhe të pranohen ashtu si që janë, gje-gjësisht të arrihet bashkëpunim maksimal mes tyre. Multikultura orientohet kah ruajtja e rrënjëve të traditës, historisë dhe trashëgimisë së secilit grup duke tejkaluar pengesat, stereotipat dhe paragjykimet ndaj grupeve të caktuara etnike.

Vizioni dhe perspektiva e shoqërisë është e varur nga siguria e qytetarëve, e cila në fakt arrihet me anë të komunikimit ndërkulturorë, tolerancës, bashkëjetesës, mirëkuptimit e dialogut brenda shoqërive të ndryshme, që padyshim ka qenë dhe mbetet nevojë jetike dhe imperativ i kohës. Këto vlera e paraqesin idealin e njerëzimit, por ato paraqesin edhe parime që e rregullojnë jetën në përgjithësi. Pikërisht arsimi multikulturor zhvillon shkathtësi për sjellje, komunikim, tolerancë dhe mirëkuptim me pjesëtarë të grupeve etnike të ndryshme, me qëllim që të tejkalohet nyja kulturore e cila mund të pengojë fitimin e arsimit të nevojshëm. Pra, ideja kryesore është që vlerat dhe elementet e multikulturalizmit, si që janë: toleranca, bashkëjetesa, respektimi dhe pranimi i dallimeve ndërmjet grupeve të ndryshme etnike, të jenë pjesë e çdo

segmenti të sistemit arsimor. Në këtë mënyrë, nxënësit në radhë të parë, e më pas edhe arsimtarët e prindërit, do të inkurajohen që t'i respektojnë dhe kuptojnë kulturat dhe traditat e bashkësive etnike të ndryshme. Pikërisht detyra kryesore e multikulturalizmit në arsim është vetëdijesimi i nxënësve për identitetin nacional, por kjo nuk nënkupton mosrespektimin e identitetit dhe kulturës së të tjerëve, dhe vetëdijesimin e nxënësve për tolerancë dhe respektim mbi dallimet ekzistuese në pikëpamje të vlerave kulturore, kombëtare, religjioze dhe dallimeve tjera ndëretnike.

Që të arrihet ky nivel, e rëndësishme është që pjesëtarët e etnikumeve të ndryshme të edukohen dhe arsimohen në atë mënyrë që të vetëdijesohen për diversitetin e botës që i rrethon, dhe rrjedhimisht të aftësohen për të respektuar dhe pranuar pa hezitim çdo ndasi dhe dallim ndërnjëror, qoftë kombëtarë, racorë, fetarë apo edhe gjinorë.

Në kuadër të kësaj, mund të përfundojmë se duhet të bëhet ndërthurje reciproke e kulturave të bashkësive të ndryshme, me ç'rast edhe edukimi dhe arsimit duhet patjetër të jenë multikulturor.

1. Arsimimi multikulturor

Arsimimi multikulturor paraqet proces i cili nga çdonjëri pjesëtarë i shoqërisë kërkon të njeh veten dhe kulturën e vetë, në mënyrë që të jetë i aftë rrjedhimisht të kuptojë veçoritë, vlerat dhe praktikat e kulturave të të tjerëve. Të mësuarit dhe njëkohësisht respektimi i kulturave të të tjerëve është sfidë për identitetin personal, e me këtë, ky proces mundëson të mësojmë si të jetojmë së bashku në një botë multikulturore. Qëllimet e kësaj filozofie janë të orientuara në drejtim të pranimit të koncepteve bazike të kulturës si dhe të kuptuarit e mënyrave të funksionimit të shoqërisë pluraliste. E kjo padyshim do të ishte pikënisje për ndërtimin e jetës së përbashkët në paqe, meqë shoqëritë shumëkulturore më parë përballëshin me konflikte të natyrave të ndryshme. Mirëkuptimi, respekti ndëretnik, ndërftuar dhe toleranca janë vlera kryesore në shoqëritë demokratike dhe shumë kulturore.

Në kohën e sotshme, përfshirja e multikulturës në procesin arsimor është tendencë globale. Pikërisht arsimit multikulturor është i domosdoshëm për shoqërinë tonë, për shkak se i përfshinë aspektet e tolerancës dhe besimit ndëretnik, për të cilat mund të themi gati se mungojnë në arsimin formal. Arsimit multikulturor promovon arsimim të bazuar mbi respektin, barazinë, lirinë dhe mundësitë e barabarta për fitimin e shkathtësive dhe për rezultate pozitive në procesin arsimor.

Krijon një rreth të sigurt dhe të suksesshëm, nxit vetëdije për globalizimin dhe inkurajon të menduarin kritik, parandalon dhe kundërshton padrejtësinë dhe diskriminimin. Pra, arsimimi multikulturor është arsim adekuat për të gjithë nxënësit. Ai refuzon çdo formë të diskriminimit në shkollë (etnik, racor, religjioz, ekonomik, gjinor, etj.), sqaron praktikatat e respektimit të dallimeve kulturore dhe mundëson një stil të mësimimit, i cili ofron strategji të pranimit të orientimeve të reja tek nxënësit, arsimtarët dhe prindërit.² Prandaj detyrë dhe qëllim primar në shoqëritë multietnike është që me përmbajtje programore dhe projekte të ndryshme multikulturore të bëhet integrimi, e me këtë edhe ngritja e nivelit arsimor dhe realizimi i vizionit për zhvillim multikulturor. Për këtë dhe shumë arsye tjera duhet ndërtuar politikë arsimore dhe strategji adekuate e cila do të jetë në funksion të implementimit të përmbajtjeve mësimore me karakter multikulturor. Që në shkollë multietnike të ketë klimë të mirë, ajo duhet të krijojë mjedis të volitshëm e të ngrohtë për punë, të krijojë bashkëpunim të mirë me prindërit, të ndërtojë sistem komunikimi të hapur, të promovojë tolerancë të ndërsjellë dhe bashkëjetesë, dhe të ketë të krijuar besim të ndërsjellë në mes etnikumeve të ndryshme prej të cilave përbëhet shkolla. Rrjedhimisht, sistemi arsimor në shoqëritë multietnike duhet gjithmonë të ketë parasysh karakterin multikulturor të shoqërisë dhe të synojë që në mënyrë aktive të kontribuojë për bashkëjetesë paqësore, bashkëveprim ndëretnik dhe tolerancë në mes grupeve dhe kulturave të ndryshme. Në kuadër të implementimit të arsimit multikulturor, rishtazi do të rritet disa prej dimensioneve më të rëndësishme të cilat mundësojnë qasje të drejtë në këtë problematikë sa aktuale aq edhe të rëndësishme.

2. Dimensione të arsimit multikulturor në shkollë

Sipas Benks-it (James A. Banks, 1999), ekzistojnë pesë dimensione të arsimit multikulturor në shkollë, që përbëjnë bazën e integritit të suksesshëm ndëretnik. Ato janë:

- » Integrimi i përmbajtjeve,
- » Procesi i përfitimit të diturive,
- » Reduktimi i paragjykimeve,
- » Përmirësimi i kulturës shkollore,

² Demirovska, E. (2012). "Multikultura në sistemin arsimor", (Doracak: Shkathësitë dhe përgjegjësitë sociale të arsimtarëve dhe punonjësve profesional në shkollë). Shkup: OSCE, f.25

» Zgjedhja e konflikteve dhe ndërtimi i paqes.³

❖ **Integrimi i përmbajtjeve** do të thotë vlerësimi i përmbajtjeve që përpunohen në lëndët e ndryshme mësimore, me qëllim që në disa lëndë të predispozuara të futen dimensione që janë në funksion të arsimit multikulturor dhe të ngritjes së shkathtësive të nxënësve për integrim ndëretnik/ndërkulturor. Për shembull, mësimdhënësi i fizikës mund të flasë për njerëz nga përkatësi të ndryshme etnike, gjuhësore dhe kulturore, që kanë dhënë kontribut në shkencë, dhe me këtë rast, të theksojë se dallimet e përmendura ndërmjet njerëzve nuk janë aspekte relevante në raport me atë që ata mund ta japin si kontribut në jetë dhe në shkencë. Me qëllim që të mundësohet që librat shkollorë të promovojnë respekt të ndërsjellë dhe të kontribuojnë për integrimin e të gjitha bashkësive etnike në shoqëri, është e domosdoshme të operacionalizohen kritere për vlerësimin e librave shkollorë nga aspekti i multikulturalitetit.⁴

❖ **Procesi i përfutimit të diturive** është një proces që zhvillohet vazhdimisht në shkollë. Përmes këtij procesi, në të vërtetë, nxënësit mësojnë të bëhen individë që janë të aftë për të menduar në mënyrë kritike. Në të vërtetë, fjala është për atë se një tekst i njëjtë mund të interpretohet në mënyra të ndryshme nga ana e njerëzve të ndryshëm, varësisht nga fakti se çfarë paragjykimesh dhe qëndrimesh kanë, por edhe me çfarë dijesh disponojnë. Pra, mësimdhënësi duhet t'i ndihmojë nxënësit që ai të mësojë se si të interpretojë tekste të caktuara, duke i identifikuar përmes çfarë supozimesh, paragjykimesh dhe qëndrimesh autori e ka shkruar atë tekst. Për shembull, mund të ngjajë që teksti ka të bëjë më inferioritetin ose superioritetin e një etnikumi, religjioni, kombi, në raport me të tjerët. Në këtë rast, mësimdhënësi duhet t'i ndihmojë nxënësit që t'i identifikojnë paragjykimet, stereotipat dhe qëndrimet e autorit të tekstit, si dhe të nxisë zhvillimin e debatit ndërmjet nxënësve. Kjo para së gjithash do të thotë se nxënësit me ndihmën e arsimtarit përgatiten të hulumtojnë perspektiva kulturore të ndryshme dhe me atë t'i kuptojnë kulturat e ndryshme. Kështu fëmijët me

³ Atanasoska, T. (2015). "Shkolla dhe misioni i saj si shtytës i ndryshimeve në shoqëri", (Doracaku: *Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritimit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë*). Shkup: Qendra maqedonase për edukim qytetar, f.59

⁴ Petroska-Beshka, V. (2009). *Multikulturalizmi dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim*. Shkup: Qendra për të drejta të njeriut dhe zgjidhje të konflikteve – UNICEF, f.119

ndihmën e konstruktimit të diturive do të kuptojnë më mirë dhe do të mësojnë të mendojnë në mënyrë kritike.

❖ **Reduktimi i paragjykimeve** paraqet një proces në të cilin insistohet që deri në maksimum të reduktohen paragjykimet tek nxënësit, ngase paragjykimet paraqesin pengesë në komunikim, atëherë kur individit ka supozime dhe qëndrime negative mbi kulturat tjera, dhe kjo sjell deri te mospajtimet në mes njerëzve. Paragjykimet ndryshojnë me shumë vështirësi, madje shpesh nuk ndihmojnë as nuk ndikojnë edhe argumentet ndaj tyre. Me forcën e argumenteve mund të ndikohet për mposhtjen e paragjykimeve dhe të stereotipave nëpërmjet procesit të gjithmbarshëm edukativo-arsimor. Për të arritur këtë, duhet ndikuar në mënyrë të qëllimshme (intencionale) tek të rinjtë që nga moshja më e vogël. Rolin kryesor në këtë kontekst e kanë prindërit, ambienti brenda të cilit individit jeton dhe zhvillohet, por gjithsesi edhe shkolla, respektivisht mësimdhënësit.⁵ Në shkollë, kjo bëhet me anë të prezantimit të përmbajtjeve dhe realizimit të aktiviteteve nga ana e mësimdhënësve, me qëllim që të pranohet pasqyra pozitive e etnikumeve të ndryshme dhe pranimi i relacioneve ndërgrupore. Kjo bëhet mu për faktin se paragjykimet shumë lehtë barten nga të rriturit tek fëmijët. Për këtë arsye puna e mësimdhënësit është shumë e ndjeshme në këtë drejtim. Ajo që duhet bërë, para së gjithash është sensibilizimi i mësimdhënësve ndaj kësaj çështjeje. Kjo do të thotë se mësimdhënësit duhet të jenë të trajnuar dhe të aftësuar që t'i njohur paragjykimet, por edhe me procedime dhe përmbajtje të mundohen që ato paragjykime t'i mposhtin dhe zhdukin. Ata duhet të njohin mirë metoda të caktuara që iu ndihmojnë për ngritjen e qëndrimeve dhe sjelljeve pozitive tek nxënësit. Në këtë proces duhet të përfshihen mësimdhënësit e të gjitha profileve. Dhe, që të arrihet kjo, me rëndësi është që arsimtarët të trajnohen t'i njohin stereotipat dhe paragjykimet etnike të vetja dhe të tjerët dhe të munden t'iu kundërvihen aktivisht paragjykimeve që manifestohen në praktikën e shkollës.

❖ **Përmirësimi i kulturës së nxënësve** e vë në fokus ambientin në shkollë në tërësi, e jo në secilën klasë veç e veç. Në nivel të tërë

⁵ Popova-Koskarova, R. (2015). "Stereotipat dhe paragjykimet në lëmin e arsimit dhe mundësitë për kapërcimin e tyre", (Doracak: *Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritetit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë*). Shkup: Qendra maqedonase për edukim qytetar, f.21

shkollës, vetë etablimi strukturor dhe organizativ, si dhe mënyra e funksionimit duhet të bëhen shembull për integrim ndëretnik. Vetë struktura e kolektivit në të cilin bëjnë pjesë përfaqësues të etnikumeve të ndryshme, por edhe pjesëmarrja e tyre e barabartë në funksionet udhëheqëse dhe organizative të shkollës, janë mënyra e vërtetë për të dhënë një shembull për atë se si duhet të funksionojë secila klasë veçmas, si dhe mbarë shkolla. Ky dimension flet për barabarësinë në kuptimin më të gjerë. Në shkollë, kultura dhe llojllojshmëria kulturore janë koncepte të cilat mësimdhënësi duhet mirë t'i kuptojë fillimisht, e më pas ti promovojë, për shkak se në atë mënyrë ndikon mbi jetën, sjelljen dhe qëndrimet e vetë nxënësve. Me plotë bindje besohet se gatishmëria e mirë e mësimdhënësit për mësimdhënie me përmbajtje multikulturore, është një mundësi e shkëlqyeshme që vlerat e multikulturalizmit të bëhen pjesë e personalitetit të çdo nxënësi. Stili dhe mënyra e ligjërimit të arsimit, pra duhet të jenë pasqyrë e praktikës dhe teorisë multikulturore, të cilat do të inicojnë ndryshime pozitive në arsim.


❖ **Zgjidhja e konflikteve dhe ndërtimi i paqes**

Ndërtimi i paqes është një term që përdoret në mbarë botën, me të cilin përshkruhen proceset dhe aktivitetet që shfrytëzohen për t'u dhënë zgjidhje konflikteve të dhunshme dhe për vendosjen e paqes së qëndrueshme. Jotoleranca ekzistuese rrjedh edhe prej asaj që nxënësit, arsimtarët dhe prindërit e grupeve të ndryshme etnike i llogarisin nxënësit e grupit “tjetër” për më të privilegjuar në një farë mënyre.⁶

Prandaj ndër qëllimet kryesore të arsimit në botën bashkëkohore, përveç tjerave është edhe arsimi në frymën demokratike në shoqëri. Sistemi arsimor duhet patjetër të ketë parasysh karakterin multikulturore të shoqërisë dhe të synojë që në mënyrë aktive të kontribuojë për bashkëjetesë paqësore dhe interaksion pozitiv në mes grupeve kulturore, sepse jetojmë në një botë ku jo gjithçka është e njëjtë dhe ku gjërat dallohen dukshëm njëra nga tjetra. Po ashtu, këto dallime kanë të bëjnë edhe me kulturat, të cilat i hasim në vendin tonë ku kemi gërshetim të kulturave të ndryshme, e cila njihet si multikulturë. Kjo është e domosdoshme që të bëhet, sepse është fakt se konfliktet ekzistojnë në realitet dhe përbëjnë një kërcënim ndaj çdo lloj integrimi. Kjo ka të bëjë edhe me integrimin ndëretnik.

⁶ Petroska-Beshka, V. (2009). *Multikulturalizmi dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim. Shkup: Qendra për të drejta të njeriut dhe zgjidhje të konflikteve* - UNICEF, f.112

Nga ajo që trajtuam më lartë, konstatojmë se Benks, iu jep të njëjtën rëndësi të gjitha dimensioneve të multikulturalizmit. E kjo, në mënyrë ilustrative do të dukej kështu:⁷



Conclusion

The existence of different ethnic and national communities is the actual situation in all Balkan countries, among which the Republic of Macedonia surely has the most heterogeneous ethnic structure. But, in today's society, every child should be educated to be involved in the society and be educated to contribute to society and the community which means to be useful to himself and the society.

The current educational practice in the Republic of Macedonia shows that all the relevant factors in the past and today, made considerable effort to fully integrate all teachers ethnic communities in the educational system of the Republic of Macedonia. Therefore, all teachers must contribute to a general multiculturalism that must become an integral part of the child's life.

At the end we are concluding, that for one multiethnic school to has a good climate, it should be established a system of open and honest communication, established mutual tolerance and coexistence, and to established trust and unity among the different ethnic groups for wich the school is constituted.

⁷ Хани, А. (2014). *Интеркултурно образование и воспитување во мултикултурни општества - Теорија за мултикултурализмот*, Shkup: TCMC, f.23

Literatura e shfrytëzuar:

1. Atanasoska, T. (2015). “*Shkolla dhe misioni i saj si shtytës i ndryshimeve në shoqëri*” (Doracaku: *Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë*). Shkup: Qendra maqedonase për edukim qytetar
2. Banks, J. A. (1999). *An Introduction to Multicultural Education* (2nd ed.). Boston: Allyn & Bacon
3. Demirovska, E. (2012). “*Multikultura në sistemin arsimor*” (Doracaku: *Shkathësitë dhe përgjegjësitë sociale të arsimtarëve dhe punonjësve profesional në shkollë*). Shkup: OSCE
4. Хани, А. (2014). *Интеркултурно образование и воспитување во мултикултурни општества - Теорија за мултикултурализмот*, Shkup: TCMC
5. Petroska-Beshka, V. (1995). *Konfliktet - Ç'janë ato dhe si zgjidhen*. Shkup: Fakulteti Filozofik (verzioni në gjuhën shqipe dhe në gjuhën maqedone)
6. Petroska-Beshka, V., Najçevska, M., Kenig, N., Ballazhi, S., Tomovska, A. (2009). *Multikulturalizmi dhe marrëdhëniet ndëretnike në arsim*. Shkup: Qendra për të drejta të njeriut dhe zgjidhje të konflikteve – UNICEF
7. Petroska-Beshka, V., Dedova, R., Ballazhi, S., Allushevski N. S., Negrievska, F. (2009). *Punëtori multikulturore për shkolla fillore* (botim i reviduar). Shkup: Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Zgjidhjen e Konflikteve dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit - USAID
8. Popova-Koskarova, R. (2015). “*Stereotipat dhe paragjykimet në lëmin e arsimit dhe mundësitë për kapërcimin e tyre*”, (Doracaku: *Pikëpamje teorike dhe praktike për zbatimin e integritit ndëretnik në fakultetet për arsimtarë*). Shkup: Qendra maqedonase për edukim qytetar
9. Salihu, L., Zabeli, N., Hoti, D. (2006). *Të drejtat e fëmijëve dhe etika e mësimdhënësit* (Tekst universitar për studentë të Fakultetit të Edukimit). Prishtinë: Qendra për arsim e Kosovës